

CODE OF CONDUCT

CODE OF CONDUCT





The Sumitomo Spirit

Banji-nissei
萬事入精

Shinyo-kakujitsu
信用確實

Fusu-furi
不趨浮利

Të dashur Kolegë,

Me një histori krenare mbi 120 vjeçare, Grupi Elektrik Sumitomo ("SEG") ka një traditë të gjatë të bërjes së biznesit në përputhje me parimet e Frymes Sumitomo. Ne përpiqemi te arrijme përsosmërinë në punën tonë, dhe integritet në bërjen e biznesit tonë. Mënyra se si ne veprojmë nuk ngelet brenda kufijëve të shkruar në letër dhe frymës së ligjeve dhe rregulloreve, por edhe në përputhje me standardet më të larta etike.

Parimet e Frymës Sumitomo, të cilat u zhvilluan 400 vjet më parë, udhëheqin aktivitetet e biznesit tonë çdo ditë. Të gjithë ne duhet të demonstrojmë Shpirtin Sumitomo në punën tonë.

- **Banji-nissei** - Bëni më të mirën e mundshme, jo vetëm në biznes por në çdo aspekt të jetës suaj.
- **Shinyo-kakujitsu** - Kushtojini rëndësi integritetit dhe administrimit të mirë.
- **Fusu-furi** - Asnjëherë mos sakrifikoni integritetin për fitime të lehta.

Ky Kod i Sjelljes, i cili është miratuar nga Keshilli ynë i Administrimit, bazohet në Frymen Sumitomo dhe përcakton standardet e sjelljes që priten nga secili prej nesh dhe na udhëheq drejt bërjes së biznesit me integritet. Megjithatë nuk mund të mbulojë çdo situatë, ai ju siguron burimet që ju duhen për të marrë vendime etike.

Secili nga ne, si anëtarë të SEG, luajmë një rol të rëndësishëm për të siguruar që i gjithë grupi ynë të respektojë ligjet dhe rregulloret. Secili prej nesh është përgjegjës për njohjen, kuptimin dhe ndjekjen e Kodit dhe të gjitha politikatat e referuara në të.

Kërkoj nga secili prej jush një angazhim personal për të bërë biznes në përputhje me Frymen Sumitomo dhe këtë Kod të Sjelljes. Referojuni këtij Kodi në punën tuaj, përdorni gjykim të duhur dhe kërkoni udhëzime nëse keni nevojë për ndihmë te metejshme. SEG ju siguron një numër vendesh për t'u drejtuar kur keni pyetje ose dëshironi të ngrini shqetësime, duke përfshirë mbikëqyrësin tuaj, Ndërlidhësin tuaj Vendor të Pajtueshmërisë dhe Departamentin Ligjor, si dhe Zyrën e Menaxhimit të Pajtueshmërisë dhe Riskut në Japoni.

Ndërsa vazhdojmë të përqendrohemi mbi rritjen e biznesit tonë, duhet të kujtojmë gjithashtu të bëjmë biznes me integritet. Faleminderit për punën që bëni për SEG çdo ditë, dhe për angazhimin tuaj për të bërë kete punë në përputhje me Frymen Sumitomo.



Osamu Inoue

President & COO

Sumitomo Electric Industries, Ltd.

Përmbajtja

ANGAZHIMI YNË NDAJ KODIT

KODI YNË.....	5
Për kë aplikohet Kodi?.....	5
Çfarë ndodh nëse ligji im vendas është i ndryshëm nga një politikë e Kodit?	5
Programi ynë i Pajtueshmërisë dhe Etikës	5
Përgjegjësitë Tona	5
Përgjegjësitë e Mbikëqyrësve dhe Udhëheqësve	6
Kërkimi i Udhëzimeve dhe Sinjalizimi i Shqetësimeve	6
Kërkimi i Udhëzimeve	6
Sinjalizimi i shqetësimeve.....	6
Linja direkte (<i>Hotline</i>).....	7
Jo hakmarrje.....	7
Pas marrjes së një sinjalizimi	7
Penalitet për Shkeljet.....	7

ANGAZHIMI YNË PËR SJELLJEN ETIKE NË BIZNES

Pajtueshmëria me Ligjet.....	8
Marrëdhënie e Drejtë dhe e Ndershme.....	8
Ne Pajtohemi me Dispozitat e Ligjeve Anti-Trust dhe te Konkurrences.....	8
Ne nuk Ofrojmë apo Marrim Ryshfet.....	9
Dhurata dhe Argëtime	10
Marredheniet me Qeverinë.....	11
Tregëtia Ndërkombëtare	11
Tregëtim i Brendshëm (<i>Insider trading</i>).....	12
Kontributet dhe Aktivitetet Politike.....	13

ANGAZHIMI YNË NDAJ SHOQERISE

Librat dhe Regjistrimet e Shoqërisë	13
Konfliktet e Interesit	13
Mbrojtja dhe Përdorimi i Duhur i Aseteve të Shoqërisë dhe Parandalimi i Mashtrimit	14
Informacioni Konfidencial dhe Pronesia Intelektuale	15
Interneti dhe Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.....	15
Kontakti me Median Apo Të Tjere	16

ANGAZHIMI YNË PËR NJERËRZIT DHE PËR AMBJENTIN TONË

Respektimi i Njëri - Tjetrit.....	17
Anti Diskriminimi dhe Ngacmimi	17
Privatësia e Punemarresit dhe të Dhënat Personale	17
Siguria ne Vendin e Punës.....	18
Cilësia	18
Pajtueshmeria me Ligjet mbi Mjedisin	18
Të Drejtat e Njeriut	18

KU MUND TË DREJTOHEM?	19
------------------------------------	----



ANGAZHIMI YNË NDAJ KODIT



KODI YNË

Kodi është një deklaratë e vlerave tona të përbashkëta dhe standardeve të sjelljes që priten nga secili prej nesh. Ai përshkruan parimet themelore dhe politikat kryesore që rregullojnë mënyrën se si ne bëjmë biznes. Për shkak se suksesi ynë varet nga reputacioni ynë, në shumë raste, politikat e përmendura në këtë Kod shkojnë përtej kërkesave të ligjit. Ju duhet ta lexoni me kujdes Kodin dhe të siguroheni që ta kuptoni atë dhe rëndësinë e tij për suksesin e Shoqerise sonë. Nëse keni ndonjë pyetje, flisni me mbikëqyrësin tuaj ose ndonjë prej burimeve të tjera të identifikuara në këtë Kod.

Për kë aplikohet Kodi?

Kodi vlen për të gjithë punëmarrësit e Shoqerise, zyrtarë dhe drejtorë, në çdo nivel, përfshirë punëmarrësit e filialeve të kontrolluara dhe ndërmarrjeve operative. Ne gjithashtu presim që partnerët tanë të biznesit të veprojnë në një mënyrë që të jetë në përputhje me parimet e Kodit tonë kur ata bëjnë biznes me ne.

Çfarë ndodh nëse ligji im vendas është i ndryshëm nga një politikë e Kodit?

Si shoqeri globale, mund të ketë raste kur një ligj vendas ose një kërkesë tjetër ligjore ndryshon nga standardet e përcaktuara në këtë Kod, ose kur ju i nënshtroheni asaj që mund të duket se është në kundërshtim me kërkesat ligjore. Ne gjithmonë respektojmë ligjet në fuqi. Nëse jeni të vetëdijshëm për një konflikt të mundshëm midis Kodit tonë dhe ligjit, kontaktoni Departamentin Ligjor për ndihmë.

PROGRAMI YNË I PAJTUESHMERISË DHE ETIKËS

Programi ynë i pajtueshmërisë dhe etikës është një shembull tjetër i angazhimit tonë për të bërë biznes në përputhje me Frymën Sumitomo. Programi ka disa qëllime të thjeshta, por kritike, të na ndihmojë të kuptojmë atë që kërkon ligji dhe të sigurojë burime për të na ndihmuar në pajtim. Zyra e pajtueshmërisë dhe menaxhimit të rrezikut e drejtuar nga Komiteti i Pajtueshmërisë SEG, ka autoritetin dhe përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e Programit tonë të Pajtueshmërisë dhe Etikës. Gjithashtu, secila nga shoqerite e grupit tonë ka një Ndërlidhës Vendor të Pajtueshmërisë i cili ndihmon me Programin, dhe i cili shërben si burim për secilin prej jush. Ky Kod është një pjesë e rëndësishme e programit dhe angazhimit të Shoqerise për etikën e biznesit.

PËRGJEGJËSITË TONA

Secili prej nesh duhet të angazhohet për sa vijon:

- Lexoni dhe kuptoni këtë Kod dhe politikat e Shoqerise sonë që vlejné për punën tuaj.
- Respektoni germën dhe frymën e ligjit, të këtij Kodi dhe politikat e Shoqerise.
- Raportoni shkeljet e njohura ose të dyshuara të Kodit, ligjit në fuqi, ose politikave të Shoqerise tek mbikëqyrësi juaj ose burimet e tjera të identifikuara në Kod.
- Kërkoni udhëzime nga mbikëqyrësi juaj, Ndërlidhësi Juaj Vendor i Pajtueshmërisë, Departamenti Ligjor, Burimet Njerëzore, ose ndonjë nga burimet e tjera të identifikuara në Kod nëse ju keni nevojë për ndihmë.
- Bashkëpunoni në hetimet e Shoqerise, auditimet dhe vlerësimet e tjera.

PËRGJEGJËSITË E MBIKËQYRËSVE DHE UDHËHEQËSVE

Nëse jeni një mbikëqyrës ose udhëheqës i Shoqerise, ju keni një detyrim të veçantë për të demonstruar vlerat e pasqyruara në Kodin tonë dhe Frymën Sumitomo, si dhe për të mbështetur punëmarrësit tanë për të bërë të njëjtën gjë. Mbikëqyrësit dhe drejtuesit e Shoqerise sonë duhet të angazhohen për sa vijon:

- **Krijoni një kulturë “shprehëse”.** Krijoni një mjedis pune në të cilin punëmarrësit ndjehen komod për të bërë pyetje dhe për të ngritur shqetësime.
- **Bëhuni shembull.** Bëhuni një shembull të të bërit biznes në përputhje me Kodin dhe Frymën Sumitomo.
- **Mbështetni Programin e Pajtueshmerise dhe Etikës.** Nxisni punëmarrësit që t’i referohen Kodit; sigurohuni që ata me të cilët punoni të njihen me politikat që zbatohen për punët e tyre; mbështesni trajnimin dhe komunikimin e Shoqerise; dhe ndihmoni në zbatimin e Programit të Pajtueshmerisë dhe Etikës në zonën tuaj.
- **Dëgjoni dhe ofroni udhëzime.** Jini të disponueshëm për punëmarrësit që vijnë tek ju për të ngritur shqetësime dhe për të bërë pyetje. Ndhmoni punëmarrësit në marrjen e vendimeve etike.
- **Referoni shqetësimet pranë departamentit përkatës.** Nëse bëheni të vetëdijshëm për sjellje të dyshimtë, referoni çështjen te Ndërlidhesi juaj Vendor i Pajtueshmerise, Departamenti Ligjor, Burimet Njerëzore, ose në ndonjë prej burimeve të tjera të identifikuara në këtë Kod.

KËRKIMI I UDHËZIMEVE DHE RAPORTIMI I SHQETËSIMEVE

Kërkimi i udhëzimeve.

Ky Kod nuk mund të adresojë çdo situatë që mund të ndodhë. Nëse nuk jeni të sigurt për atë që kërkon ligji ose politika e Shoqerise, ose nëse e gjeni veten në një situatë të vështirë etike, kërkoni udhëzime nga një prej burimeve të shumta të dobishme për ju, duke përfshirë edhe mbikëqyrësin tuaj, Ndërlidhesin Vendor te Përputhshmërisë, Departamentin Ligjor, ose Burimet Njerëzore.

Sinjalizimi i shqetësimeve.

Nëse bëheni të vetëdijshëm për një shkelje të dyshuar ose faktike të ligjit, Kodit, ose politikave të Shoqerise sonë, ju keni përgjegjësinë ta sinjalizoni atë. Sinjalizimi i shkeljeve të dyshuara ose shqetësimeve të tjera ndihmon për të mbrojtur Shoqerine tonë, kolegët tuaj dhe komunitetet tona. Shoqeria jonë ju siguron një numër mënyrash ku mund të sinjalizoni një shqetësim, duke përfshirë:

- Mbikëqyrësi juaj
- Ndërlidhesi juaj Vendor i Pajtueshmerisë
- Departamenti Ligjor
- Burimet Njerëzore
- Linja direkte (e brendshme / e jashtme)

Pyetje

Unë nuk ndihem rehat për diçka që po ndodh në punë, por nuk kam prova të forta se Kodi ynë po shkelet. Çfarë duhet të bëj?

Pergjigje

Ju duhet të kërkoni udhëzime, ose të sinjalizoni shqetësimin tuaj, duke përdorur burimet e përshkruara në Kod. Nëse prisni, mund të jetë tepër vonë për të parandaluar dëmtimin e Shoqerise ose të tjerëve nga një shkelje e mundshme. Shoqeria do të hetojë çështjet në mënyrë të duhur.

Linjë direkte (Hotline)

Shoqeria jonë u siguron punëmarrësve një linjë direkte (*hotline*) që ata mund të telefonojnë ose të dërgojnë *email* për të sinjalizuar shkelje të dyshuar ose të kërkojnë udhëzime mbi politikën e Shoqerise ose mbi ligjin në fuqi. Në shumicën e vendeve, punëmarrësit mund të kontaktojnë *Hotline* në mënyrë anonime. Ligjet që rregullojnë linjat direkte janë të ndryshme në disa vende dhe nganjëherë më kufizuese. Në këto raste, duhet të konsultoheni me burimet e përshkruara në këtë Kod, udhëzuesin tuaj të brendshëm të Shoqerise ose faqen tuaj intranet lokale për më shumë informacione nëse mundeni të sinjalizoni dhe, nëse po, si të bëni ndonjë sinjalizim nga vendi ku jeni.

Jo hakmarrje

Shoqeria jonë ndalon hakmarrjen ndaj punëmarrësve për kryerjen e një sinjalizimi në mirëbesim të shkeljeve të dyshuara. Nëse jeni të vetëdijshëm për hakmarrjen (kundër jush ose një punëmarrësi tjetër), sinjalizojeni menjëherë Departamentit Ligjor ose ndonjë prej burimeve të tjera të identifikuara në këtë Kod. Shoqeria jonë do të hetojë çështjen dhe do të ndërmarrë veprime përkatëse.

Pas marrjes së një sinjalizimi

Sinjalizimet për shkelje të dyshuara do të hetohen siç duhet dhe do të trajtohen në mënyrë konfidenciale në masën e mundur. Ju nuk duhet të bëni hetimin tuaj. Hetimet shpesh përfshijnë çështje të ndërlikuara juridike, dhe të veprosh vetë mund të rrezikojë një hetim dhe të ndikojë negativisht si tek ti ashtu edhe te Shoqeria.

PENALITETET PËR SHKELJE

Në varësi të ligjit në fuqi, personeli i Shoqerise që shkel ligjin, këtë Kod, ose politikën e Shoqerise, mund të jenë subjekt i një veprimi disiplinor, deri dhe në zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Për më tepër, çdo mbikëqyrës që drejton ose miraton një shkelje, ose ka njohuri për shkelje dhe nuk e sinjalizon atë menjëherë, mund të jetë subjekt i një veprimi disiplinor.

ANGAZHIMI YNË PËR

SJELLJEN ETIKE NË BIZNES



PAJTUESHMERIA ME LIGJET

Aktivitetet e biznesit të Shoqërisë sonë i nënshtrohen një numri të madh ligjesh, rregullash dhe veprimtarish zbatimi në të gjithë botën. Panorama ligjore dhe rregullatore në të cilin veprojmë është jashtëzakonisht sfiduese. Në Shoqërinë tonë, ne e kuptojmë se pajtueshmëria me ligjin në fuqi është një pjesë e rëndësishme e detyrimit tonë ndaj komuniteteve tona. Ne jemi të përkushtuar ndaj respektimit të ligjit dhe rregulloret që zbatohen ndaj nesh.

MARRËDHËNIE E DREJTË DHE E NDRERSHME

Ne bëjmë biznes me ndershmëri dhe integritet. Ne ndërveprojmë me drejtësi me klientët tanë, furnizuesit, konkurrentët, punëmarrësit, rregullatorët dhe me gjithë të tjerët. Ne nuk përfitojmë nga padrejtësia e të tjerëve përmes pandershmërisë ose praktikave të padrejta të biznesit. Ne prodhojmë mallra dhe ofrojmë shërbime për të cilat mund të jemi krenarë. Kur bëjmë *marketing*, ne përshkruajmë produktet dhe shërbimet tona në një mënyrë të drejtë dhe të saktë.

NE PAJTOHEMI ME DISPOZITAT E LIGJEVE ANTI-TRUST DHE KONKURENCËS

Ndërsa Shoqëria konkurrin fuqishëm në të gjitha aktivitetet e saj të biznesit, përpjekjet e saj në treg duhet të bëhen në përputhje me ligjet e zbatueshme të anti-trustit dhe konkurrencës. Disa nga shkeljet më serioze të anti-trustit janë marrëveshjet midis konkurrentëve që kufizojnë gjykimin e pavarur të një shoqërie, siç janë marrëveshjet për të caktuar çmimet, për të kufizuar prodhimin, për të kontrolluar cilësinë e produkteve ose për të ndarë një treg për klientët, territoret ose produktet. Ju nuk

duhet të bini dakord me ndonjë konkurrent në lidhje me ndonjë prej këtyre temave, pasi këto marrëveshje janë praktikisht gjithmonë të paligjshme dhe në kundërshtim me politikën e Shoqërisë. Marrëveshjet e paligjshme nuk duhet të jenë detyrueshme me shkrim dhe as të jenë marrëveshje të shprehura. Gjykatat mund të gjykojnë se marrëveshjet e bazuara në diskutime jo-formale ose thjesht shkëmbim i informacionit ndërmjet konkurrencës mund të rezultojnë në një marrëveshje të paligjshme.

Kini kujdes që të mos diskutoni ose shkëmbeni me konkurrentët tanë (madje edhe në një takim joformal) informacion sensitiv nga pikepamja e konkurrencës, i cili nuk është në domëin publik, siç janë:

- Çmimet aktuale ose të ardhshme, marzhet e fitimit ose strategjia e çmimeve dhe termat e lidhura me çmimet (shtesë, ulje, zbritje)
- Informacione të hollësishme mbi kostot (p.sh. në lidhje me inputet domethënëse) në lidhje me produktet specifike
- Informacione strategjike që zbulojnë qasjen e Shoqërisë për të negociuar me klientë specifikë, duke synuar klientë specifikë ose aktivitete strategjike
- Detaje të ofertave të reja të shërbimeve që janë informacion sensitiv në konkurrencë, planet e marketingut dhe të produkteve
- Informacione në lidhje me kompensimin ose përfitimet e punëmarrësve.

Duke bashkuar konkurrentët, shoqatat tregtare mund të krijojnë shqetësime mbi konkurrencën e pandershme, edhe pse grupe të tilla mund të shërbejnë gjithashtu shumë qëllime legjitime. Ju duhet të njoftoni Ndërlidhesin tuaj Vendor të Përputhshmërisë ose Departamentin Ligjor përpara se të bashkoheni në një shoqatë tregtare ose të merrni pjesë në një takim në të cilin mund të diskutohen tema sensitive nga pikepamja e konkurrencës. Shoqeria jonë ka procedura të hollësishme që rregullojnë këto situata. Për informacion shtesë, konsultohuni me Rregullat e Pajtueshmerise me Ligjet e Konkurrencës.

Aktivitete të tjera që mund të krijojnë shqetësime në bazë të ligjeve të anti-trust dhe konkurrencës janë:

- Marrëveshja me një furnizues për të kufizuar shitjet e furnizuesit të konkurrentet e Shoqerise
- Kontrolli i çmimeve të rishitjes në transaksione me distributorët ose ndërmjetësit tregtare
- Refuzimet kolektive për t'u hyre ne marrëdhënie tregtare me një konkurrent, furnizues ose klient
- Marrëveshje ekskluzive që kanë të bëjnë me një shoqeri kur shoqeria kërkon që një klient të blejë nga, ose një furnizues t'i shese, vetëm asaj shoqerie
- Marrëveshjet kushtezuese (*tying*), kur i kërkohet një klienti ose furnizuesi, si kusht për blerjen e një produkti, blerja e nje produkti të dytë, të veçantë
- “Çmime grabitqare”, kur një shoqeri ofron një zbritje, nga rezulton se çmimi i shitjes së një produkti është nën koston e produktit, me qëllimin për të mbajtur atë çmim te ulet për aq kohë sa të nxjerre konkurrentët jashtë tregut.

Nuk është gjithmonë e qartë nëse një aktivitet është anti-konkurrues, prandaj ju lutemi këshillohuni me Ndërlidhesin Vendor të Pajtueshmerise, Zyrtarin e Pajtueshmerise me Ligjin e Konkurrencës, ose Departamentin Ligjor për udhëzime.

Pyetje

Një mik i ngushtë i imi nga kolegji punon për një nga konkurrentët tanë. Javën e kaluar, ai më pyeti për informacion sensitiv nga pikepamja e konkurrencës për një nga produktet tona më të shitura. Unë shmanga çështjen, por do të doja disa udhëzime në rast se ndodh përsëri.

Pergjigje

Ju duhet të shmangni absolutisht të folurit për informacione sensitive nga pikepamje e konkurrencës me cilindo nga konkurrentët e Shoqerise. Ndërsa ne e kuptojmë se, në situata sociale, ndonjëherë mund të jetë e vështirë të veprosh siç duhet, duhet t'i shpjegoni mikut tuaj që politika SEG ju ndalon rreptësisht të flisni për çmimet ose kushtet e tjera të shitjes me konkurrencën.

NE NUK OFROJME APO MARRIM RYSHFET

Ryshfeti shkakton një dëm të madh në komunitet dhe mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme ndaj Shoqerise. Ryshfeti përfshin ofrimin, dhënien ose marrjen e çdo vlere për të ndikuar në një vendim biznesi ose për të marrë një avantazh të biznesit në mënyrë të padrejtë. Ju nuk duhet, ne menyre te drejtpërdrejte ose te terthorte, të autorizoni, të ofroni, premtoni, jepni ose kerkoni, ose të pranoni të merrni ose të pranoni ryshfet.

Ryshfeti nuk përfshin gjithmonë pagesa në para. Ryshfetet paraqitet ne disa forma, duke përfshirë argëtimin, zbritje të papërshtatshme, punësimin e një anëtari të familjes për dikë që kërkon të ndikosh, apo edhe të bësh kontribute bamirësie për të ndikuar në një vendim biznesi. Një ryshfet mund të jetë çdo gjë me vlerë për marrësin. Përveç kësaj, shumë e ryshfetit të ofruar ose të paguar është e parëndësishme. Nëse ju kërkohet të bëni një pagesë të parave ose ndonjë gjë tjetër që mund të përbëjë ryshfet, sinjalizoni menjëherë në Departamentin Ligjor.

Shumica e vendeve kanë ligje që ndalojnë ryshfetin e zyrtarëve qeveritarë. Nëpunësit e organizatave qeveritare (të tilla si një shoqëri shtetërore e telekomunikacionit, ndërmarrje energjetike ose spital) konsiderohen zyrtarë qeveritarë sipas shumicës së ligjeve kundër ryshfetit. Shumë vende gjithashtu ndalojnë ryshfetin e individëve ose ndërmarrjeve private. Shoqëria ndalon rreptësisht çdo lloj ryshfeti qofte ky per zyrtare qeveritare, individë apo shoqëri. Shkeljet e legjislacionit te zbatueshëm mund te rezultojnë ne pasoje te renda per ju dhe Shoqerine tone, perfshire këtu dem ndaj emrit te mire tonin, gjoba te renda, si dhe burgosje per individed. Ju duhet te shmangni çdo aktivitet qe dhe mund te sugjeroje diçka te tille.

Shoqëria mund të mbaje përgjegjësi për një ryshfet që është kryer nga palë të treta në lidhje me biznesin e Shoqërisë sonë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm në zgjedhjen e partnerëve dhe agjentëve tanë të biznesit, dhe të verifikojmë, kur është e përshtatshme, për të siguruar që ata nuk marrin/japin ryshfete në emrin tonë. Zbatoni procedurat e Shoqërisë sonë kur lidhni marrëdhënie me palët e treta. Dhe, kurrë mos injoroni shenjat paralajmëruese që një partner biznesi mund të jete i përfshire në veprimtari të paligjshme ose joetike. Nëse jeni të vetëdijshëm se njëri nga partnerët tanë të biznesit është, ose mund të jetë duke dhënë ose duke marrë ryshfete, njoftoni sa më shpejt që të jetë e mundur Nderlidhësin tuaj te Vendor te Pajtueshmerise, Menaxherin e Parandalimit të Korrupsionit ose Departamentin Ligjor.

Në përgjithësi, sjelljet e mira te biznesit të vogël, siç janë shpenzimet e arsyeshme për ushqimet që lidhen drejtpërdrejt me promovimin e biznesit ose performancën e kontratës, nuk janë të ndaluara. Sidoqoftë, ligjet që rregullojnë sigurimin e vakteve dhe sjelljen e mire te biznesit për zyrtarët qeveritarë janë komplekse dhe ato ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Për të siguruar pajtueshmërinë, duhet të merrni miratimin paraprak nga Zyrtari juaj për Parandalimin e Korrupsionit dhe Departamenti Ligjor përpara se t'i siguronit një zyrtari qeveritar një vakt, dhuratë, argëtim, shpenzime të udhëtimit ose çfarëdo kortezie biznesi. Ju gjithashtu duhet të mbani shënime të sakta të shpenzimeve të bëra.

Pyetje

A ka ndonjë shenjë paralajmëruese që mund të tregojë që partneri i biznesit ose agjenti ynë mund të marrë pjesë në korrupsion?

Përgjigje

Po, ka disa shenja “red flags” që duhet t’i keni parasysh në marrëdhëniet e biznesit tuaj me ndonjë partner ose agjent biznesi, përfshirë këtu nëse:

- Transaksioni i biznesit po zhvillohet në një vend me reputacion për korrupsion.
- Partneri ose agjenti i biznesit nuk ka aftësitë e kërkuara për të kryer punën ose për të siguruar shërbimet e kërkuara.
- Partneri ose agjenti i biznesit kërkon kushte të pazakonta pagese, siç janë pagesa të mëdha paraprakisht, ose kërkon që pagesa t’i bëhet në një llogari ose një personi në një vend tjetër.
- Partneri ose agjenti i biznesit nuk pranon të pajtohet me dispozitat tona kundër korrupsionit në kontratën tonë.
- Partneri ose agjenti i biznesit është i lidhur me një zyrtar qeveritar me autoritet vendimmarrës mbi biznesin tonë.

DHURATA DHE ARGËTIME

Kur jeni i përfshirë në marrjen e vendimeve të biznesit në emër të Shoqërisë, vendimet tuaja duhet të bazohen në gjykim të pa kompromentuar dhe objektiv. Kurrë mos pranoni dhurata ose përfitime të tjera nëse gjykimi ose vendimet e biznesit tuaj mund të preken, ose mund të duket se preken nga dhurata.

Kurrë nuk duhet të kërkonti dhurata, argëtim ose ndonjë sjellje tjetër te mire biznesi nga njerëz që bëjnë biznes me Shoqërinë. Dhurata ne mjete monetare ose ekuivalente te mjeteve monetare të tilla si kartat e dhuratave në çfarëdo sasive janë të ndaluara pa miratimin paraprak me shkrim. Dhënia ose marrja e ndonjë dhurate ose argëtimi në formën e ryshfetit është e ndaluar. Ne gjithashtu nuk japim ose pranojmë kurrë argëtim ose dhurata që janë në kundërshtim me standardet e Shoqërisë sonë të respektimit të individëve.

Dhuratat e pakërkuara dhe sjelljet e mira në biznes, përfshirë ushqimin dhe argëtimin, janë të lejueshme nëse ato janë sjellje të zakonshme dhe zakonisht të pranuar nga biznesi; jo të tepërta në vlerë dhe as të shpeshta; dhe të dhëna dhe pranuar pa një kuptim të shprehur ose të nënkuptuar se marrësi është i detyruar në çfarëdo mënyre nga pranimi i dhuratës. Dhuratat që janë ekstravagante në vlerë ose të natyrës së pazakontë nuk duhet të ofrohen ose pranohen pa miratimin paraprak me shkrim të Zyrtarit të Parandalimit të Korrupsionit.

Shumë nga furnizuesit dhe klientët tanë kanë politika të tyre mbi dhuratat dhe argëtimin. Kini kujdes që mos ta siguronit ose pranoni me vetëdije një dhuratë ose argëtim që shkel politikën e dhuratës dhe argëtimin të ndërmarrjes tjetër.

Pyetje

Unë dua t'i dhuroj një prej klientëve tanë më të mirë një dhuratë të veçantë në shenjë falenderimi. Kam mundësi të marre bileta teatri që e di që ajo do t'i vlerësojë, por mendoj se është kundër politikës së shoqërisë së saj që ajo t'i pranojë ato. Nëse ajo nuk e ka problem të shkelë politikën dhe është e gatshme të shkojë, a mund t'i dhuroj biletat?

Përgjigje

Jo. Nëse e dini që dhënia e një dhurate do të shkelë politikën e shoqërisë së marrësit, nuk duhet t'i jepni dhuratën. Nëse nuk jeni të sigurt nëse një dhuratë është e lejueshme, duhet të pyesni. Ashtu siç duam që të tjerët të respektojnë standardet tona, ne do të duhet të respektojmë standardet e tyre.

MARRËDHËNIET ME QEVERINË

Rregulla të ndryshme - dhe shpesh shumë të rrepta zbatohen për marrëdhëniet tona me agjencitë qeveritare dhe zyrtarët në shumë fusha të biznesit, përfshirë dhuratat dhe argëtimet, punësimi, dhe madje edhe thjesht komunikimi me të tjerët. Çfarë është e pranueshme në mjedisin e biznesit tregtar mund të mos jetë e pranueshme në

marrëdhëniet tona me qeverinë. Ka ligje që rregullojnë ofrimin e dhuratave, ushqimit, argëtimit, udhëtimit dhe përfitime të tjera për zyrtarët qeveritarë dhe nëpunësit. Ju e keni të ndaluar të ofroni dhurata, argëtim ose ndonjë gjë me vlerë për zyrtarët qeveritarë, nëpunësit ose anëtarët e familjeve të tyre në lidhje me biznesin e Shoqërisë pa miratimin paraprak me shkrim nga Zyrtarit juaj për Parandalimin e Korrupsionit dhe Departamenti Ligjor. Rregulla të veçanta parashikohen gjithashtu për punësimin e një zyrtari qeveritar ose një anëtar të familjes së tij për të punuar në Shoqëri tonë. Nëse po mendoni të paraqisni një ofertë punësimi një zyrtari qeveritar ose një anëtar të familjes të një zyrtari qeveritar, së pari duhet të kontaktoni Departamentin Ligjor për të siguruar që ju të respektoni ligjin në fuqi.

Gjithashtu, në të gjitha bashkëveprimet tona me zyrtarë qeveritarë dhe nëpunës, është thelbësore që të sigurohemi që të gjitha deklaratat dhe komunikimet të jenë të vërteta, të plota dhe të sakta. Ne gjithashtu duhet të regjistrojmë siç duhet gjatë gjithë kohës, kostot dhe tarifat në llogaritë e duhura. Dhe, kur është e zbatueshme, ne duhet të sigurohemi që t'i zbatojmë të gjitha kërkesat për trajtimin e informacionit konfidencial dhe sensitiv të qeverisë.

TREGËTIA NDËRKOMBËTARE

Shoqëria jonë bën biznes në të gjithë botën, dhe ne veprojmë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi që përcaktojnë mënyrën se si ne bëjmë biznes përtej kufijve, përfshirë mënyrën sesi ne importojmë dhe eksportojmë produkte. Ne gjithashtu i nënshtrohemi ligjeve dhe rregulloreve që na ndalojnë të bëjmë biznes në disa vende ose me persona ose organizata të caktuara. Nëse përgjegjësitë tuaja përfshijnë shitjen ose transferimin e mallrave, shërbimeve ose teknologjisë midis vendeve, edhe nëse ndërmjet ose midis filialeve të SEG, ju duhet të qëndroni të informuar për ligjin aktual dhe politikën e Shoqërisë në këtë fushë dhe të kontaktoni pranë Departamentit Ligjor nëse keni ndonjë pyetje.

TREGËTIM I BRENDSHËM (*Insider trading*)

Ne veprojmë në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme të titujve me vlerë. Ju nuk duhet të blini ose shisni tituj të Shoqërisë kur posedoni informacione jo-publike thelbësore (ndonjëherë të quajtura “informacione të brendshme”) në lidhje me Shoqërinë. Kjo njihet si “tregtim i brendshëm” (*insider trading*), dhe është e paligjshme. Informacioni i brendshëm është informacioni që një investitor do të konsideronte të rëndësishëm në vendimin nëse do të blejë ose shesë një titull. Shembuj përfshijnë rezultatet financiare, kontrata të reja ose të pa fituara, informacione mbi produktet, rezultatet e shitjeve dhe ndryshime të rëndësishme të personelit. Kalimi i një informacioni të tillë të dikush që mund të blejë ose tituj, i njohur si “*tipping*” është gjithashtu e paligjshme. Ndalimi vlen për titujt e SEG dhe titujve të ndërmarrjeve të tjera nëse mësoni informacione jo-publike thelbësore për shoqëri të tjera (siç janë furnizuesit ose blerësit tanë) gjatë detyrave tuaja për SEG.

Pyetje

Ju mësoni gjatë punës se Shoqëria juaj ka mundësi të blje një shoqëri interesante që merret me teknologji gjatë muajve në vijim. Pa i treguar detaje, ju i sugjeroni vëllait tuaj që ai mund të doje të blejë disa aksione në atë shoqëri. Ka ndonjë problem me këtë qasje?

Pergjigje

Po, ka një problem. Edhe pse ju nuk i keni dhënë detaje vëllait tuaj, ju jeni angazhuar në “*tipping*” duke i sugjeruar që ai të blejë aksione në shoqërinë e teknologjisë.

Pyetje

Gjatë punës time, dëgjova se një prej klientëve tanë së shpejti do të njoftojë se do të lidhë një kontratë të rëndësishme. A mund të blej aksione në shoqërinë e tyre?

Pergjigje

Jo sepse kjo përfshin informacionin e brendshëm të klientit, të cilin e keni marrë gjatë punës tuaj me Shoqërinë tonë.

KONTRIBUTET DHE AKTIVITETET POLITIKE

Ne zbatojmë të gjitha ligjet që rregullojnë pjesëmarrjen e Shoqërisë sonë në çështjet politike, përfshirë ato ligje që rregullojnë dhe si kontribuojmë për kandidatët, partitë politike dhe nëse kërkojmë të ndikojmë në veprimet e qeverisë. Ligjet në këtë fushë janë komplekse, dhe ato ndryshojnë në vendet e ndryshme ku Shoqëria jonë zhvillon biznes. Ju duhet të konsultoheni me Ndërlidhësin tuaj Vendor të Pajtuësmerisë, Zyrtarin e Parandalimit të Korrupsionit dhe Departamentin Ligjor përpara se të përdorni burimet e Shoqërisë sonë në mbështetje të një kandidati politik ose partie, ose para se të ndërveproni drejtpërdrejt ose tërthorazi me një zyrtar publik në emër të Shoqërisë sonë në mënyrë që të ndikojë në legjislacionin ose veprimin e qeverisë.

Pyetje

Një menaxher më kërkoi të kontribuoja për një kandidat politik. Ai më tha që Shoqëria do “të ta kthej nderin”. A lejohet kjo?

Pergjigje

Jo, kjo nuk lejohet. Ju duhet të refuzoni kërkesën dhe të raportoni çështjen duke përdorur burimet e përkrahura në këtë Kod.

ANGAZHIMI YNË PËR SHOQERINE



LIBRAT DHE REGJISTRIMET E SHOQERISE

Në Shoqerine tonë, ne i plotësojmë të gjitha dokumentet e biznesit me saktësi, vërtetësi dhe në kohën e duhur, duke përfshirë edhe të gjitha raportet e udhëtimit dhe shpenzimeve. Ne gjithashtu bëjmë deklaratime të plota, të drejta, të sakta dhe në kohë në lidhje me raportet dhe dokumentet që paraqisim pranë rregullatorëve qeveritarë, përfshirë raportet tona periodike financiare. Kur është e zbatueshme, dokumentet duhet rregullisht të autorizohen. Ne regjistrojmë aktivitetet financiare të Shoqerise në përputhje me ligjet në fuqi dhe praktikën e kontabilitetit. Ne nuk duhet të bëjmë nderhyrje të rreme ose mashtruese në procesverbalet e Shoqerise dhe asnjëherë të mos të përfshijmë informacionin nga procesverbalet kur kërkohen që të regjistrohen.

Ne gjithashtu duhet të ruajmë të dhënat e Shoqerise sipas kohëzgjatjes dhe mënyrës së kërkuar nga ligji dhe politika e Shoqerise.

Pyetje

Është java e fundit në periudhën tremujore të raportimit. Shefi im dëshiron të sigurohet që të plotësojmë numrat tanë për tremujorin, kështu që ai më kërkoi që të regjistroja një shitje edhe pse dokumentacioni nuk do të konkretizohet. Unë mendoj se kjo nuk do të dëmtojë askënd - a duhet ta bëj atë që ai thotë?

Pergjigje

Jo, nuk duhet. Përveç kur një politikë parashikon ndryshe, shitjet mund të raportohen vetëm pasi të jetë përfunduar kontrata. Ju duhet ta raportoni këtë çështje në Departamentin Ligjor, Divizionin e Kontabilitetit, ose përmes ndonjë prej burimeve të tjera të identifikuar në këtë Kod.

Pyetje

Një koleg ju kërkoi të fshini disa *emaille* të caktuara sepse beson se do të ngrihet një proces gjyqësor dhe *emaillet* mund të jenë të turpshme. Mund ta bëni këtë?

Pergjigje

Jo. Kjo do të shkelë politikën tonë - dhe mundësisht ligjin - në lidhje me ruajtjen e regjistrimeve të rëndësishme për një mosmarrëveshje ligjore. Ju duhet të raportoni çështjen sipas procedurave që ndodhen në këtë Kod.

KONFLITET E INTERESIT

Në Shoqerine tonë, të gjithë kemi përgjegjësi të marrim vendime që prekin Shoqerine bazuar në interesat më të mirë të saj, të pavarur nga ndikimet e jashtme. Një konflikt interesi ndodh kur një interes personal ka potencial të ndërhyjë në aftësinë tuaj për të kryer punën tuaj për Shoqerine tonë në mënyrë objektive dhe efektive. Detyrimi ynë për të bërë biznesin e Shoqerise sonë në një mënyrë të ndershme dhe etike përfshin trajtimin e duhur të situatave që krijojnë një konflikt interesi, ose që madje krijojnë perceptimin midis të tjerëve se një konflikt mund të ekzistojë. Nëse keni besim se keni një konflikt, ose nëse keni njohuri për një konflikt të mundshëm, ju duhet t'ia shpalosni atë, menjëherë, mbikëqyrësit tuaj, Ndërlidhësit Vendor të Pajtuësmerise, ose Departamentit Ligjor.

Ndërsa është e pamundur të përshkruani çdo situatë ku mund të lindë një konflikt interesi, më poshtë janë disa shembuj të llojeve të situatave që mund të krijojnë konflikte dhe që duhet të sinjalizohen:

- **Interesat financiare** në shoqeri që bëjnë ose kërkojnë të bëjnë biznes me Shoqerine tonë, përfshirë klientët ose furnizuesit, ose në konkurrentet tanë. Ne nuk duhet të lejojmë që investimet tona financiare personale të ndikojnë, ose të duket se ndikojnë në gjykimin tonë të pavarur në emër të Shoqerise sonë. Kjo mund të ndodhë në shumë mënyra, por konfliktet kanë të ngjarë të ndodhin kur ju keni një investim në një konkurrent, furnizues, ose klient dhe palet e treta mund të përfitojnë nga vendimet tuaja në emër të Shoqerise sonë.
- **Punësimi**, pranë ose duke qenë këshilltar i konkurrenteve të Shoqerise sonë, një furnizuesi, klienti ose partneri tjetër biznesi.
- **Drejtimin e biznesit të Shoqerise sonë tek një furnizues, një agjent, një distributor ose një kontraktor** i cili është në pronësi ose menaxhim të drejtpërdrejt ose të tërthortë nga anëtarët e familjes suaj, ose miq të ngushtë.
- **Mundësitë e korporatës**, që do të thotë të përfitosh nga një mundësi biznesi për të cilën behesh i/e vetëdijshme për shkak të punës tënde në Shoqerise sonë.
- Marrja në punë, promovimi, ose mbikëqyrja e një **anëtar të familjes** në Shoqerine tonë.
- **Te shërbesh në këshillin e administrimit ose organi tjetër këshillues i një organizate** që është konkurrenente, klient ose furnizues i Shoqerise sonë.

Pyetje

Kunata ime zotëron një shoqeri që dëshiron të bëhet një furnizues i Shoqerise sonë. Ata ofrojnë shërbimin më të mirë me çmimin më të mirë, dhe do të doja të angazhoja shoqerine e saj. A është ky një konflikt interesi?

Pergjigje

Mund të jetë, edhe nëse mendoni se shoqeria e kumatës suaj do të ofronte vlera më të mira për Shoqerine tonë sesa konkurrentët e saj. Ju duhet ta shpalosni këtë situatë tek Mbikëqyrësi ose Ndërlidhesi Vendor për Pajtueshmërinë. Ju nuk duhet të përfshihen ose të ndikoni në vendimin nëse duhet të bëre biznes me shoqerine e kumatës suaj apo jo. Dhe, nëse shoqeria e kumatës suaj bëhet furnizues, ju nuk duhet të mbani një pozicion vendimmarrës ose mbikëqyrës në lidhje me furnizuesin dhe nuk duhet të ushtroni ndonjë ndikim në marrëdhëniet midis Shoqerise sonë dhe furnizuesit.

MBROJTJA DHE PËRDORIMI I DUHUR I ASETVE TË SHOQERISE DHE PARANDALIMI I MASHTRIMIT

Të gjithë ne kemi për detyrë të mbrojmë asetet e Shoqerise sonë, dhe të parandalojmë dhe raportojmë mashtrimet dhe vjedhjet. Mashtrimi, vjedhja, pakujdesia dhe shpërdorimet kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në fitimet e Shoqerise sonë. Përveç rasteve të autorizuara, asetet e Shoqerise, përfshirë koha e Shoqerise, pajisjet, materialet, burimet dhe informacione mbi to, duhet të përdoren vetëm për qëllime biznesi. Kur largoheni nga Shoqeria, e gjithë pronat e Shoqerise duhet të kthehet në Shoqeri.

Pyetje

A mund t'u ofroj furnizuesve tanë informacione në lidhje me biznesin *catering* të gruas sime?

Pergjigje

Jo. Dhenia e informacionit furnizuesve tanë mbi biznesin *catering* të gruas suaj është i palejueshëm sepse do të përfshijë përdorimin e burimeve të Shoqerise (listën tonë të furnizuesve) për qëllime të biznesit privat. Furnizuesit tanë mund të ndihen të detyruar të bëjnë biznes me shoqerine e gruas suaj, dhe kjo mund të ndikojë në marrëdhëniet e Shoqerise sonë me furnizuesit tanë.

INFORMACIONI KONFIDENCIAL DHE PRONESIA INTELEKTUALE

Të gjithë kemi përgjegjësi për të mbrojtur informacionin konfidencial të Shoqerise sonë dhe palëve të treta përfshirë këtu dhe klientët. Ne nuk i tregojmë informacionet konfidenciale askujt brenda ose jashtë Shoqerise, përveç nëse kërkohet me ligj dhe autorizohemi në mënyrë të duhur. Ne ndjekim politikat e Shoqerise për mbrojtjen e informacionit të tillë kundër vjedhjes ose keqpërdorimit nga të tjerët. Informacioni konfidencial përfshin të gjitha informacionet jo-publike që mund të jenë të dobishme për konkurrentët, ose të dëmshme për Shoqerine tonë ose klientët e saj dhe palët e tjera të treta nëse zbulohen. Shembuj të informacionit konfidencial përfshijnë

- Të dhëna financiare
- Sekrete tregtare dhe *know-how*
- Mundesi blerje dhe shitje
- Informacioni i klientit dhe furnizuesit
- Informacioni i punëmarrësve tanë
- Planet e marketingut

Detyrimi juaj për të trajtuar informacionin si konfidencial vazhdon pasi të përfundojë punësimi me Shoqerine, dhe ju gjithashtu nuk mund të perhapni informacione konfidenciale të punëdhënësit te mëparshëm për Shoqerine tonë. Gjithashtu, ne nuk përdorim mjete të paligjshme ose jo-etike (të tilla si vjedhje, spiunazh ose keqpërfaqësim) për të marrë informacionin konfidencial të të tjerëve.

Ne gjithashtu respektojmë dhe mbrojmë pronesine intelektuale të Shoqerise sonë dhe të shoqerive të tjera. Mos çënoni patentat, të drejtat e autorit, markat dhe lloje të tjera të pronesise intelektuale dhe ndërmerni hapat e duhur për te mbrojtur pronesine intelektuale. Nëse keni pyetje për pronesine intelektuale konsultohuni me Departamentin Ligjor dhe Departamentin e Pronesise Intelektuale.

Pyetje

Një ish-koleg më kërkoi një kopje të një raporti konfidencial që kishte përgatitur kur ishte ende i punësuar nga Shoqeria jonë. A mund tia jap?

Pergjigje

Jo. Fakti që ish-kolegu juaj më parë kontribuoi në krijimin e raportit gjatë punësimit nga Shoqeria jonë nuk do të thotë që i lejohet të marrë një kopje tani. Ju duhet të flisni me mbikëqyrësin tuaj se si t'i përgjigjeni kësaj kërkesë.

INTERNETI DHE PËRDORIMI I TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Shumë prej nesh kanë akses në internet në punën tonë ose në kompjuterët personalë dhe telefonat. Ndërsa përdorimi i rastit i pajisjeve personale teknologjike në punë mund të lejohet, kini kujdes të mbronni reputacionin e Shoqerise sonë dhe informacionin e biznesit. Asnjëherë mos postoni komente në internet, përfshirë në media sociale, që shpifin, ngacmojnë ose kërcënojnë të tjerët. Dhe mos postoni komente në emër të Shoqerise nëse nuk jeni autorizuar posaçërisht për ta bërë atë.

Ju duhet të respektoni të gjitha politikat e Shoqerise sonë kur përdorni burimet teknologjike të Shoqerise. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të merrni të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kompjuterin tuaj dhe burimet e tjera të teknologjisë. Nëse keni ndonjë arsye të besoni se fjalëkalimi juaj ose siguria për çfarëdo arsye e një kompjuteri, telefoni ose burimi tjetër teknologjik i Shoqerise është komprometuar në çfarëdo mënyre, ju duhet të ndryshoni fjalëkalimin tuaj menjëherë dhe të raportoni incidentin, nëse ne Japoni, tek Drejtori Kryesor i Sigurisë ose Shërbimi i Ndihmës së Incidenteve në Sigurinë Kibernetike, ose nëse është jashtë Japonisë, në Departamentin tuaj të Teknologjisë së Informacionit.

Të gjithë skedarët personale të ruajtur në kompjuterët e Shoqerise janë pronë e Shoqerise. Në masën e lejuar nga ligji në fuqi, Shoqeria mund të rishikojë çdo skedar të ruajtur ose transmetuar në kompjuterin dhe burimet e tij të komunikimit, përfshirë mesazhet e postës elektronike.

Pyetje

Mbikëqyrësi im më kërkoi fjalëkalimin e kompjuterit tim sepse unë do të jem me pushime. A mund t'ia jap?

Pergjigje

Jo. Nuk ka asnjë arsye biznesi që kërkon të jepni fjalëkalimin tuaj te mbikëqyrësi juaj.

Pyetje

Unë isha duke lexuar një artikull *on-line* që përmban informacion të rremë në lidhje me biznesin tonë. Do të doja të përgjigjesha. A mundem?

Pergjigje

Ju nuk duhet t'i përgjigjeni artikullit nëse nuk jeni autorizuar ta bëni këtë nga Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun. Në vend të kësaj, duhet ta referoni artikullin në Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun ose Departamentin Ligjor, i cili mund të përgjigjet ne emër te Shoqerise.

KONTAKTI ME MEDIAN DHE TË TJERE

Shoqeria jonë shpesh pranon kërkesa për informacion nga media, analistë financiarë dhe të tjerë. Qëllimi ynë është të komunikojmë në mënyrë të saktë, të vazhdueshme dhe në përputhje me ligjet, në lidhje me zbulimin e drejtë të informacionit për shoqerite publike.

Nëse nuk jeni një zëdhënës zyrtar i Shoqerise, ju nuk mund të komunikoni me median, analistë, aksionarë/ortake, në media sociale, ose gjatë si një përfaqësues i Shoqerise, përveç nëse jeni autorizuar posaçërisht për ta bërë këtë nga Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun. Mos u përpiqni t'i përgjigjeni një pyetje në media vetë, edhe nëse mendoni se e dini përgjigjen. Kërkesat për informacion financiar ose informacion tjetër në lidhje me shoqerine nga media, komuniteti financiar, aksionarët/ortaket ose publiku duhet t'i referohen Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun. Kërkesat për informacion nga rregullatorët ose qeveria duhet t'i referohen Ndërlidhësit tuaj Vendor të Pajtueshmerise dhe Departamentit Ligjor.

ANGAZHIMI YNË PËR

NJERËRZIT DHE PËR AMBJENTIN TONË



RESPEKTIMI I NJËRI TJETRI

Mënyra se si ne trajtojmë njëri-tjetrin ndikon në mënyrën se si ne bëjmë punët tona. Të gjithë duam dhe meritojmë një vend pune ku trajtohemi me respekt. Të gjithë ne kemi një përgjegjësi të kontribuojmë në krijimin e një mjedisi të tillë, dhe mbikëqyrësit kanë një përgjegjësi të veçantë për të nxitur një vend pune që mbështet ndershmërinë, integritetin, respektin dhe besimin.

ANTI DISKRIMINIMI DHE NGACMIMI

Në Shoqerine tonë, ne vlerësojmë, mbështesim dhe respektojmë diversitetin dhe përfshirjen si çelës për suksesin tonë si një shoqeri mbareboterore. Për këtë arsye, ne nuk bëjmë diskriminim në bazë të racës, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, fesë, moshës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, paaftësisë, apo ndonjë karakteristike tjetër të mbrojtur nga ligjet në fuqi. Disa shaka ofenduese, komente, foto, gjeste, ose prekja në lidhje me një karakteristikë të mbrojtur mund të përbëjnë ngacmim, të cilin Shoqeria jonë nuk e toleron.

Pyetje

Disa nga punëmarrësit e tjerë në grupin tim bëjnë shaka me pamjen time fizike. E di që nuk e bëjnë me qëllim të keq ndaj meje, por kjo shaka më shqetëson dhe u kam kërkuar që të ndalen. Ata u përgjigjen se unë duhet të përmirësoja sensin tim të humorit. Çfarë duhet të bëj?

Pergjigje

Ju duhet të informoni Burimet Njerëzore, Departamentin Ligjor ose Ndërlidhesin tuaj Vendor të Pajtuësmerise. "Shakaja" që ju përshkruani nuk perben shaka për Shoqerine tonë. Përkundrazi, mund të jetë një cenim ndaj përkushtimit tonë për paanësi, respekt dhe dinjitet.

Pyetje

Ju dëshironi të aplikoni për një vend pune në një pjesë tjetër të Shoqerise sonë, por ju është thënë se mbikëqyrësi i pozicionit mendon se roli duhet të plotësohet nga një punëmarrës i ri mashkull. A lejohet kjo?

Pergjigje

Jo. Shoqeria nuk i lejon qëndrimet diskriminuese mbi gjininë, moshën, apo ndonjë kategori tjetër e mbrojtur me ligj për të ndikuar në vendimet e marrjes në punë. Ju duhet ta raportoni çështjen te ndonjë prej burimeve të identifikuara në Kod.

PRIVATËSIA E PUNEMARRESVE DHE TË DHËNAT PERSONALE

Ne e respektojmë privatesine dhe dinjitetin e të gjithë individëve. Shoqeria jonë mbledh dhe mban informacione personale që lidhen me punësimin tuaj, përfshirë informacionin mjekësor dhe mbi përfitimet. Shumë vende rregullojnë mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin "të dhënave personale" nga shoqerite, te cilat përfshijne emrat e individëve, adresat dhe informacione të tjera. Kujdes i veçantë është treguar për të kufizuar aksesin në informacionet personale për personelin e Shoqerise me nevojën për të njohur informacione të tilla per qëllime të ligjshme biznesi. Punemarresit që janë përgjegjës për ruajtjen e informacionit personal dhe ata të cilëve u jepet informacion i tillë nuk duhet të zbulojnë informacione private në kundërshtim me ligjin në fuqi ose politikatat e Shoqerise.

Ju duhet të njiheni dhe të respektoni politikatat e Shoqerise si dhe ligjet dhe rregullat që kanë të bëjnë me punën tuaj.

Pyetje

Ju mësoni se një koleg po përpiket të hyjë në adresat e shtëpive të punëmarrësve të tjerë dhe numrat e telefonit në mënyrë që t'i njoftojë ata rreth një ngjarje në komunitet. A duhet të bëni ndonjë gjë?

Pergjigje

Jo. Ju duhet t'i shpjegoni kolegut se nuk mund përdorë informacionin për këto qëllime. Nëse besoni se ai/ajo, megjithatë, mund të përpiket ta bëjë këtë, duhet ta raportoni çështjen tek mbikëqyrësi juaj, Burimet Njerëzore, ose duke përdorur procedurat e tjera të listuara në këtë Kod.

SIGURIA NE VENDIN E PUNËS

Shoqeria është e përkushtuar që t'i mbajë punëmarrësit të shëndetshëm dhe të sigurojë që punëmarrësit të gëzojnë një vend të sigurt pune, dhe ne e ndajmë të gjithë këtë përgjegjësi. Ju duhet të njiheni me të gjitha udhëzimet e sigurisë dhe të ndiqni ato si dhe të sinjalizoni çdo kusht të pasigurt të punës ose aksidente në vendin e punës. Çdo akt apo kërcënim dhune verbale ose fizike ndaj një personi tjetër ose abuzim me pronën e Shoqerise duhet t'i sinjalizohet menjëherë Sigurisë, mbikëqyrësit juaj, ose burimeve të tjera të përshtatshme të Shoqerise.

Ju nuk duhet të sinjalizoni apo të punoni nën ndikimin e drogerave të paautorizuara ose jashtëligjshme apo nën ndikimin e pijeve alkoolike. Asnjë punëmarrës nuk duhet të sjelle arme në vendin e punës (përveç kur lejohet nga ligji i zbatueshëm).

Pyetje

Mbikëqyrësi im më kërkoi të anashkaloja disa kontrole të kërkuara të sigurisë për të arritur një afat kohor. Çfarë duhet të bëj?

Pergjigje

Mos i anashkaloni këto procedura. Pavarësisht se dikush ju kërkon të bëni diçka, nëse e dini se është e gabuar, mos e bëni atë. Nëse nuk ndiheni mire që ta diskutoni çështjen me mbikëqyrësit tuaj, kontaktoni eprorin e mbikëqyrësit tuaj, Departamentin Ligjor ose ndonjë nga burimet e tjera të identifikuar në këtë Kod.

CILËSIA

Shoqeria jonë është vazhdimisht e angazhuar t'ju ofrojë produkte dhe shërbime me cilësi të lartë. Ky angazhim për cilësinë shtrihet në çdo pjesë të organizatës sonë - në çdo biznes dhe në çdo vend.

Pyetje

Ne përdorim një kontraktor për të menaxhuar disa substanca të rregulluara. Bazuar në disa komente që kam dëgjuar nga punëmarrësit e tyre, mendoj se mund të mos jenë duke i menaxhuar këto substanca në mënyrë të ligjshme. Meqenëse është një kontraktor që është nuk vepron në përputhje me rregullat e pajtueshmërisë, a ka rëndësi për ne?

Pergjigje

Po, ka rëndësi. Ajo që po bën kontraktori mund të krijojë përgjegjësi për Shoqerine tonë, dhe, edhe nëse nuk do të kishte përgjegjësi ligjore, do të mbetet ende çështje e rëndësishme. Mos shiko në anën tjetër, nëse keni arsye të mendoni se njëri nga partnerët tanë të biznesit nuk vepron në përputhje me ligjet. Bisedoni me mbikëqyrësit tuaj, Ndërlidhesin tuaj Vendor të Pajtueshmërisë, Departamentin Ligjor, ose ndonjë prej burimeve të tjera të identifikuar në këtë Kod.

PAJTUESHMËRIA ME LIGJET MBI MJEDISIN


Shoqeria jonë është e angazhuar për administrimin mjedisor dhe zvogëlimin e ndikimit mjedisor nga aktivitetet tona. Ne veprojmë në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme të mjedisit. Ne jemi të gjithë përgjegjës për njohjen e përgjegjësive mjedisore që i zbatohen në punët tona, dhe për kryerjen e biznesit në përputhje me ato përgjegjësi.

TË DREJTAT E NJERIUT


Shoqeria jonë është e përkushtuar të mbështesë dhe zhvillojë të drejtat e njeriut në të gjitha komunitetet ku veprojmë. Ne jemi kundër punës së fëmijëve dhe skllëvërve dhe i trajtojmë të gjithë me dinjitet dhe respekt. Ne gjithashtu inkurajojmë kontraktorët dhe furnizuesit tanë të mbështesin dhe avancojnë të drejtat e njeriut. Ne preferojmë të punojmë me ata që ndajnë dhe mbështesin aktivisht vlerat e Shoqerise.

**JAM DUKE U PËRBALLUR
ME NJË DILEMË ETIKE.**

KU DUHET TË DREJTOHEM



Ju inkurajoheni të bëni pyetje dhe të kërkonti udhëzime. Të gjithë ne kemi përgjegjësi të shprehim dhe të sinjalizojmë sjellje për të cilat besojmë se janë të paligjshme, të pasigurta ose joetike. Ngritja e shqetësimeve mbron si Shoqerine ashtu edhe punëmarrësit tanë. Ka disa mënyra se si mund të kërkonti udhëzime ose të shprehni shqetësime. Shoqeria ndalon hakmarrjen ndaj kujtqo që ngre pyetje ose shqetësime me mirëbesim.




KONTAKTONI ME
**BURIMET
NJERËZORE**



KËRKONI
UDHËZIME NGA
**NJË NDËRLIDHES
VENDOR TE
PAJTUESHMERISE**



KONTAKTONI
**DEPARTAMENTIN
JURIDIK**



FOL ME
**MBIKEQYRESIN
TËND**

RAPORTO ONLINE. TELEFONOI
HOTLINE-T OSE SHKRUAJ NJË EMAIL:

**[http://global-sei.com/company/
compliance-hotlines.html](http://global-sei.com/company/compliance-hotlines.html)**

Sumitomo Electric Group's Code of Conduct (Code of Conduct)

Compliance Committee, Sumitomo Electric Industries, Ltd.

(Office: Compliance Group, Compliance & Risk Management Office)

April 2018, First Edition, Code of Conduct (Code of Conduct)

 Sumitomo Electric Industries, Ltd.

Sumitomo Electric Industries, Ltd.
4-5-33 Kitahama, Chuo-ku
Osaka 541-0041, Japan

<http://global-sei.com>